



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 3292/2 prot.

Gramsh, më 02 / 09 / 2025

VENDIM

Nr.75 , date 29. 08. 2025

Për

Miratimin e dokumentacionit për aplikim për bursë sipas kritereve të përcaktuara në VKM 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, për nxënësit në sistemin arsimor parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional:

Këshilli Bashkiak i mbledhur në datë 29/ 08 / 2025, Mbështetur në Ligjin nr. 139 / 2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika “ k”, në V.K.M., nr. 666 datë 10.10.2019, “ Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve, për përfitimin e bursave e të pagesave, për nxënësit e arsimit parauniversitar si dhe format e tjera ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore prauniversitare publike ”, i ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27. 07. 2022 si dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit, lidhur me miratimin e aktit normativ përsa i përket dokumentacionit që dorëzon nxënësi aplikues për bursë”, sipas kritereve të përcaktuara në V.K.M., nr. 666 datë 10.10.2019, i ndryshuar

VENDOSI :

- I. Mitatimin e dokumentacionit , që duhet të dorëzojnë nxënësit aplikues për bursë, të arsimit parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë, brenda kuotave dhe kritereve si më poshtë :

2.1 Kriteri ekonomik:

- a) **Nxënësit e arsimit parauniversitar që e kanë shkollën mbi 5 km larg nga vendbanimi i tyre i përhershëm, me të ardhura sipas Pasqyrës 1 dhe që akomodohen në konvikte publike**

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega qe vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (Nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim të ardhurash, ku çdo anëtar madhor të familjes të vërtetojë statusin e tij, me një nga vërtetimet: (vërtetim page, punëkërkuksi, PAK, pension pleqërie, pension invaliditeti, vërtetim studenti)
8. Vërtetim pagese, NE, duke vendour shumën lekë (vërtetim i muajit të fundit nga Nj. Administrative)
9. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka aktivitet privat / biznes në familjen e tij

- b) Nxënësit e arsimit parauniversitar të cilët banojnë në zona rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes 5 km, të cilët plotësojnë kriterin sipas ekonomik sipas Pasqyrës 1 dhe që akomodohen në konvikt.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (Nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim të ardhurash, ku çdo anëtar madhor të familjes të vërtetojë statusin e tij, me një nga vërtetimet: (vërtetim page, punëkërkuar, PAK, pension pleqërie, pension invaliditeti, vërtetim studenti)
8. Vërtetim pagese, N.E, duke vendur shumën lekë, (vërtetim i muajit të fundit nga Nj. Administrative)
9. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
10. Vërtetim nga Njësia Administrative që nuk ka shkollë 9-vjeçare brenda rrezes 5 km të Nj. administrative

- c) Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë rregjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
6. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka , aktivitet privat / biznes, në familje
7. Vërtetim nga Nj. Administrative se nxënësi / nxënësjë, është në pamundësi financiare, për arsye të ndryshme, (braktisje nga prindrit,etj)

2.2 Kriteri i rezultateve të arritura:

Nxënësit e arsimit profesional të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), përfitojnë bursë të plotë.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
4. Certifikatë personale
5. Certifikatë familjare
6. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon , klasa...)
7. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
8. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
9. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes në familje
10. Dëftesë shkolle e vitit paraardhës me notë mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë)

2.3 Kriteri joekonomik:

- a) Nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit:

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)

4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega qe vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim i statusit të jetimit
8. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes në familje

b) Nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prinderore me vendim gjukate të formës së prerë

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega qe vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vendim gjukate i formës së prerë për humbjen e kujdestarise prinderore

c) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik, tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuar të vërtetuar nga komisioni mjekoligjor:

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
8. Vërtetim mbi statusin e invaliditetit para-tetraplegjik dhe pagesën e PAK. (mund të shkarkohet nga e-albania ose të merret tek Njësia Administrative)

ç) Nxënës, që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega qe vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim nga konviktet (mbi regjistrimin apo pamundësinë për akomodim)
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
8. Vërtetim nga Komisioni Mjeko-ligjor (K.M.C.A.P), për vërtetimin e aftësisë së kufizuar të nxënësit

d) Nxënës, fëmijë të personit / personave që gëzojnë statusin e invalidit.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për bursë
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega qe vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt

6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
8. Vërtetim mbi statusin e invaliditetit të prindit / prindërve

dh) Nxënësit e pakicës rome dhe egjiptiane të cilët rregjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për burse
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
8. Vërtetim nga Shoqata e Romëve / Egjiptianëve

e) Nxënës që janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për burse
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
8. Vërtetim nga Ministria e Brendshme.

ë) Nxënës, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit....., që kanë rënë në krye të detyrës

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për burse
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon , klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
8. Vërtetim nga Ministria e Brendshme

f) Nxënëset (vajza) që ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për burse
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, në një nga degët sipas pikës "f")
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka / nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.

g) Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për burse
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim regjistrimi nga shkolla (dega që vazhdon, klasa...)
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.
8. Vërtetim nga shoqata e jetimëve / gjendja civile.

gj) Nxënëset (vajza), të cilat regjistrohen në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, përjashtuar ato që përfitojnë nga shkronja "F", e këtij vendimi, trajtohen me 50% të bursës.

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për burse
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, në degë, përjashtuar ato degë që ndodhen në pikën "f")
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.

2.4 Kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm:

- a) Nxënësit të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional, në drejtimet mësimore, bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim vendburimeve të naftës dhe gazit

Dokumentat që duhet të depozitohen:

1. Kërkesë e nxënësit / kryefamiljarit, për aplikim për burse
2. Certifikatë personale (mund të shkarkohet nga e-albania)
3. Certifikatë familjare (mund të shkarkohet nga e-albania)
4. Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, në një degë sipas pikës "a" të kriterit "2.4")
5. Vërtetim për regjistrim / akomodim në konvikt
6. Vërtetim vendbanimi (nga Nj. Administrative)
7. Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka, aktivitet privat / biznes, në familje.

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

- a) Janë ndarë nga trangu familjar;
- b) Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- c) Deklarohen mbetës apo persëritës, dhe humbsin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalueve

II. Verifikimi i vërtetësisë së dokumentave, kryhet nga administrata Bashkiake, para shpalljes e listës së nxënësve, përfitues të bursës

III. Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është data 25 Tetor të çdo viti shkollor

IV. Ky akt normativ, hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
ENIS ZANI

